Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Kreshnik Spahiu	**10.11.2023**	**12.11.2023**	**2023/0823**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 21.10.2023, OE "SHM Architecture SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0823, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Zhvillimi i projektit ideor dhe te hollësishëm [zbatues kryesor], te arkitekturës dhe te inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit te ri ne Peje, ne përputhje me Kategorinë III te rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukture te stadiumeve, te miratuara nga UEFA." me nr. të prokurimit: "207-23-3988-4-1-3", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK. AK ka zbatuar procedurë të hapur të konkursit të projektimit, vlera e çmimeve të cilat do te shpërblehen: Çmimi 1 – Nuk duhet të kaloi vlerën 155,000.00 Euro, Çmimi 2: 7,000.00 €, Çmimi 3: 3,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë: Neni 10 par 3 i Ligjit Nt.04/L-237 – {Mjetet për promovimin e Transparencës}, i plotësuar dhe ndryshuar me nenin 6 par 2 të Ligjit Nr. 05/L-068.

Pretendimet ankimore

Me datën: 21.10.2023, OE "SHM Architecture SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0823, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Zhvillimi i projektit ideor dhe te hollësishëm [zbatues kryesor], te arkitekturës dhe te inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit te ri ne Peje, ne përputhje me Kategorinë III te rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukture te stadiumeve, te miratuara nga UEFA." me nr. të prokurimit: "207-23-3988-4-1-3", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK. AK ka zbatuar procedurë të hapur të konkursit të projektimit, vlera e çmimeve të cilat do te shpërblehen: Çmimi 1 – Nuk duhet të kaloi vlerën 155,000.00 Euro, Çmimi 2: 7,000.00 €, Çmimi 3: 3,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë: Neni 10 par 3 i Ligjit Nt.04/L-237 – {Mjetet për promovimin e Transparencës}, i plotësuar dhe ndryshuar me nenin 6 par 2 të Ligjit Nr. 05/L-068.

Sipas specifikave te dosjes se tenderëve ne kemi dorëzuar aplikacionin/tenderin ne kopje fizike- një origjinal dhe dy kopje poashtu edhe një kopje ne mënyrë elektronike-USB (ashtu siç është kërkuar).

Ne hapje nuk kemi pas te drejt te marrim pjese. Për pranimin e aplikacioneve për procedurën e cekur jemi njoftuar përmes platformës eprokurimi me date 16.06.2023.

Me date 09.10.2023 kemi pranuar dokumentin numër B58 Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues përmes te cilit jemi njoftuar se asnjë prej pjesëmarrësve ne konkursin ne fjale nuk ka plotësuar kriteret. Konkretisht aplikacioni yne nen emërtimin/shifrën 1861 është eliminuar sipas dokumentit ne fjale për:

1.3-Materices se programit, i cili mungon,

1.4-Raportit mbi qasjen dhe metodologjinë projektuese, i cili mungon.

Me te marre këtë njoftim dhe duke qene te bindur se dokumentacionin ne fjale ka qene pjese e dorëzuar nga ne në aplikacionin tone, kemi paraqitur kërkesë për qasje ne dokumentacion dhe hapje te kopjes konform Nenit 10 te LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS. Kërkesën e kemi dorëzuar përmes emailit elektronik te zyrtarit përkatës dhe kemi ngarkuar ne platformën eprokurimi me date 11.10.2023. Ne po te njëjtën date kemi marr konfirmim nga Zv.Drejtori i Prokurimit pranë MKRS-se për te drejtën ne qasje

ne dokumentacion, por jo edhe te drejtën e hapjes se kopjes se aplikacionit.

Me date 12.10.2023 ne kemi prezantuar ne zyrën e prokurimit pranë MKRS-se dhe kemi marr dokumentin e vlerësimit te aplikacioneve ku edhe dukshëm kemi qene aplikacioni qe ka plotësuar te gjitha kërkesat, por ne kërkesën tone qe ne pranin tone, ne pjesëmarrjen tone te hapim kopjen qe te shohim se mungojnë dokumentet siç ceket edhe ne raportin e vlerësimit kemi marr përgjigje negative.

Andaj duke pas për baze nenin Neni 10- Mjetet për promovimin e Transparencës te LIGJIT Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, me date 12.10.2023 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim të aplikacionit tone dhe ne prezence te përfaqësueseve tanë te bej hapje e kopjes se aplikacionit me shifër 1861. Me date 13.10.2023 kemi Pranuar Vendimin e AK, me te cilin kërkesa jone refuzohet me arsyetimin se: OE nuk kane te drejte ne hapjen/qasjen ne dokumente pasi qe një gjë te tillë e ndalon nenin 10 paragrafi 8 te LPP.

Konsiderojmë se AK gabimisht ka vendosur kur ka marr për baze nenin 10 par 8 te LPPsë, duke anashkaluar ne tërsi dispozitën e nenit 6 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-237 për Prokurimin Publik, i cili përcakton se: *"3. Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që* është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (*iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2 të nenit 62 të këtij ligji* ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur".

Pra kjo dispozite rregullon ne mënyrë strikte obligimin e autoritetit kontraktues qe te sigurojë qasje cilësdo palë të interesit, ne të dhënat e përshkruara si ne paragrafi 1 dhe 2 të nenit 10 të ligjit bazik, perveq qasjes ne informatave sekrete afariste. për me tepër edhe paragrafi 5 i nenit 10 të ligjit bazik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-068, ka përcaktuar se: "*5. Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do ti sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë e qasjes sipas paragrafit 3 të këtij neni", andaj një refuzim bazuar ne nenin 10 par 8 te LPP nga ana e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se është shmangie e qëllimshme nga përgjegjësia ligjore dhe vendimmarrës.*

Ne rastin konkret qasja është kërkuar nga ne si OE aplikues, dhe vetëm lidhur me dosjen e dorëzuar nga Ne, andaj edhe kushti për informata sekrete afariste këtu bie, respektivisht nuk mundet AK të kufizojë qasjen tonë. Duke qenë shumë të sigurt ne atë që Ne kemi dorëzuar, konsiderojmë se mosdhënia e qasjes, si dhe anulimi ynë nga ky Konkurs Projektimi, kinse per shkak te mungesës se dokumenteve te kërkuara sipas dosjes dhe specifikacionit teknik, është i pa qëndrueshëm dhe totalisht i pabazuar, andaj kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit, që bazuar ne mandatin ligjor që i ka dhe LPP, të kërkoj nga ana e AK që ti siguroj kopje e dosjes ne origjinal, dhe që pas vlerësimit te saj, Ankesën tonë ta aprovoje në tërësi si të bazuar, dhe lëndën ta kthejë në Rivlerësim.

KRITERET PËR VLERËSIM

Aneksi 1. Specifikimet teknike dhe/ose estetike të detyrueshme

Dokumentet që përbëjnë koncept projektin

- Seksioni 1.3. Projekti ideor i tërësisë, arkitekturës dhe inxhinierisë konstruktive
- Produkti 1.3. Matrica [e përshtatur/ përditësuar] e programimit.
- Seksioni 1.4. Projekti ideor i tërësisë, arkitekturës dhe inxhinierisë konstruktive
- Produkti 1.4. Raport mbi qasjen dhe metodologjinë projektuese.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Në raportin e komisionit të vlerësimit në lidhje me tenderin e OE ankues me shifrën 1861 shënohet:

Dokumentacioni pennba.ne USE, 1 origjinal te projektit dhe 2 kopje. Me kete dëshmon se e plotëson kushtin e parë. Operatori ekonomik ka konkuruar me dokumentacion dhe duke dorëzuar dokumentet e kërkuara sipas thirrjes publike, ne nje origjinal dhe dy kopje, ne versionin fizike dhe digjital ne përbërje te:

1.1-Projektit ideor te tërësisë,

1.2-Projektit ideor te arkitek1.ures dhe inxhinierisë konstruktive,

1.3-Matrices se programit, i cili mungon

1.4-Raportit mbi qasjen dhe metodologjinë projektuese, i cili mungon

1.5-Materialit ekspozuese (te përberë përkitazi nga 6 panele).

Nen kriteret:

Inovacioni -

Ne këtë projektim inovacioni është trajtuar, mirëpo është dashur pak me gjerësisht pasi qe vetëm pjesërisht e ka hartuar këtë pjesë dhe vlerësohet me 5 pike. 50%

Vlerat estetike –

Si vlere estetike është trajtuar mjaft mire, është trajtuar edhe ne pjesën e akustikës. Objekti është i ndare ne 4 pjese, ku secila tribune ka nda1jet dhe ka mundësi qarkullimi emergjent cila i duhet objektit sportiv për një zbrazje mete shpejt gjate zbrazjeve emergjente ne loje. Nuanca e mbulesës është shumë e hapur dhe për temperaturat e larta fate shume reflektuese dhe nuk e tërheq nxehtësinë.

Për këtë projekti vlerësohet me 20 pike. 100%

Vlera Funksionale -

- Mungon tuneli i lojtareve 3m e gjere qe tërhiqet, ku pjesa e daljes se lojtareve është dhe ka hapësirë për vendosjen e këtij tuneli, por nuk është i paraqitur;

- Komentimi - duhet te jene 3 ne projekt, por janë vendosur vetëm 2;

- Trar1smebmi kompleks nuk është, duhet te jete një hapësirë prej 400rn2;

- Media punon 20 m2 - nuk është vërejtur;

-VOC -nuk është vërejtur;

- CCTV - nuk është vërejtur;

- Numri i ulëseve nuk është paraqitur me cope - i numëruar;

- Disnivli i madh për daljen e lojtareve -1.5m;

- Vip tribunat duhet te jene 100 ndërsa janë paraqitur vetëm 60 tribuna;

- Spektator mjekësor te paktën lx15 m2 - nuk është.

Vlera funksionale merr 20 Pikë. 66.66 %

Përshtatja adekuate me mjedisin përreth - Projektimi është bere mjaft mire, ku gjithçka është përshtatur edhe gjelbërimi është trajtuar mjaft mire bashkë me parkingjet e parapara dhe vlerësohet me piket maksimale 10 Pike. 100%

Për mospërmbushjen e këtyre kushteve si 1.3-Matrices se programi, i cili mungon 1.4-Raportit mbi qasjen dhe metodologjinë projektuese, i cili mungon ky projekt vlerësohet si i pa përgjegjshëm.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Eksperti me datë 13.11.2023, ka kërkuar nga AK që të sjellë në OSHP origjinalin dhe njërën kopje të propozimit të dërguar nga OE ankues. Në të njëjtën ditë AK ka sjellë në OSHP materialet e kërkuara.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **SHM Architecture SH.P.K.**

Sqarim hyrës: OE ankues me datë 12.10.2023 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim në AK. Me datë 13.10.2023 AK ka marr vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor: OE ankues pretendon se vendimi i AK-së për diskualifikimin në këtë konkurs projektimi për shkak të mungesës së dokumenteve të kërkuara sipas dosjes së tenderit është i pabazuar. Gjithashtu, moslejimi i hapjes së kopjes së propozimit të OE ankues është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP-së).

Vlerësimi i Ekspertit

Fillimisht, eksperti sqaron se në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit AK ka zbatuar procedurën e Konkursit të Projektimit, me shpërblimet si vijon: çmimit i parë në vlerën maksimale 155,000.00 Euro, çmimi i dytë në vlerë prej 7,000.00 dhe çmimi i tretë 3,000.00.

Dorëzimi i propozimeve është bërë në formë fizike në Zyrën e Prokurimit në Ministrinë e Kulturës Rinisë Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente (më tej Ministria). Në dosjen e tenderit, përkatësisht Aneksin 1-Specifikimet teknike të detyrueshme në lidhje me dorëzimin AK ka kërkuar: "*Vulosja dhe shënimi i tenderëve Pjesëmarrësit duhet të dorëzojnë një [1] origjinal dhe dy [2] kopje te origjinalit: Një [1] ORIGJINAL: Një [1] origjinal i Dokumentacionit të kandidatit- në formë të shtypur; Një [1] origjinal i Dokumentacionit të kandidatit- në formë digjitale, [Një CD ose një Pajisje për ruajtje të të dhënave (Data storage device)]. Një [1] origjinal i Projektit ideor- në formë të shtypur; Një [1] origjinal i Projektit ideor- në formë digjitale, [Një CD ose një Pajisje për ruajtje të të dhënave (Data storage device)]. Dy [2] KOPJE TE ORIGJINALIT: Një [1] kopje të origjinalit të Dokumentacionit të kandidatit- në*

formë të shtypur; Një [1] kopje të origjinalit të Dokumentacionit të kandidatit- në formë digjitale; [Një CD ose një Pajisje për ruajtje të të dhënave (Data storage device)]. Një [1] kopje të origjinalit të Projektit ideor- në formë të shtypur; Një [1] kopje të origjinalit të Projektit ideor- në formë digjitale; [Një CD ose një Pajisje për ruajtje të të dhënave (Data storage device)]".

Më tej, sipas shkresave të lëndës, OE ankues ka dorëzuar një origjinal dhe dy kopje të propozimit me kodin 1861.

AK, në vendimin e datës 09.10.2023 konstaton se Juria Profesionale e rekomandon anulimin e procedurës, si rezultat qe asnjëra nga shifrat (ofertat) nuk plotësojnë kriteret administrative gjate fazës se vlerësimit. Më tej në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar AK ka specifikuar arsyetimin e eliminimit p;r OE ankues si vijon: "*Për mospërmbushjen e këtyre kushteve si 1.3 Matricës së programit, i cili mungon 1.4 Raportit mbi qasjen dhe metodologjinë projektuese, i cili mungon. Ky projekt vlerësohet si i papërgjegjshëm*."

OE ankues me datë 11.10.2023 ka dorëzuar kërkesën për qasje në dokumentacionin e vlerësimit dhe ka kërkuar hapjen e kopjes së ofertës cila është dorëzuar së bashku me origjinalin. Në të njëjtën ditë zv.Drejtori i Prokurimit ka njoftuar palën për të drejtën e qasje ne dokumentacion e vlerësimit, por ka refuzuar mundësinë e hapjes se kopjes se aplikacionit.

Me date 12.10.2023 ka marrë raportin e vlerësimit të tenderëve (propozimeve) por jo edhe qasjen apo mundësinë e hapjes së kopjes së ofertës.

OE ankues si palë e pakënaqur me vendim e AK-së, me datë 12.10.2023 ka dorëzuar në AK kërkesën për rishqyrtim me pretendimet e njëjta ankimore sikurse në këtë ankesë.

AK me datë 13.10.2023 përmes vendimit ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim. Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK ka dhënë arsyetimin si vijon: "*Zyra e Prokurimit në MKRS jep qasje aq sa e lejon e drejta për qasje ne dokumente te Prokurimit konkretisht pranoni detajet mbi qasjen ne dokumentet tuaja: I/e nderuar. Jeni te ftuar nesër ne ora 10:00 për qasja ne dokumentacionin fizik dhe vlerësimin sipas kërkesës suaj Zyra 021 MKRS. Deri nesër në këtë kohe do te analizohet Ligji dhe rregulloret për të verifikuar nëse lejohet hapja e kopjes apo jo. Bazuar në analizën e Ligjit konkretisht në nenin ku ju jeni thirrur: Neni 10. Mjetet për promovimin e Transparencës te Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, pika 8. Autoritet i kontraktues do t'i siguroje një eksperti shqyrtues. KRPP-se ose OSHP-së dhe ose një panel i shqyrtues. qasje ne kopjet e cilitdo aktivitet te prokurimit duke përfshire edhe informatat sekrete afariste dhe çfarëdo informata te tjera qe kane te bëjnë me prokurimin. menjëherë pas kërkesës se te mësipërme. Autoriteti kontraktues gjithashtu do t i siguroje qasje dhe kopje te shënimeve dhe informatave e një gjykate kompetente nëse qasja ose kopjet e tilla kërkohen nga një urdhër i nxjerre nga gjykata e tille. Autoriteti kontraktues menjëherë do te siguroje qasjen dhe kopjet e kërkuara ne mënyrë te rregullt dhe pa pengesa. Pra. ne asnjërën nga pikat nuk specifikohet qe Operatori Ekonomi mund të ketë qasje ne kopjet e tyre. Te njëjtat mund të hapen vetëm me kërkesë te OSHP-se ne momentin që kërkohet për tu hapur dosjet dhe me ndonjë vendim nga Gjykata. Matricat A3 dhe Raporti deri ne 50 faqe nuk janë bashkangjitur ne origjinalin e vlerësuar nga Komisioni Vlerësues dhe janë vërejtur ne fazën vlerësuese. Andaj pretendimi i juaj është i pabazuar. Po*

ashtu specifikohet qarte ne raport qe shifra 1861 - I .5-Material i ekspozues (te përberë përkitazi nga 6 panele) - nuk është i kompletuar i Ofertuesi ka prezantuar 2 panela (pllakata) mungojnë -1- panele (pllakate) Le përqendruara ne Projektin ideor te arkitekturës dhe inxhinierisë konstrukti e dhe 15 vizatime ne hamer kjo është shpjeguar dje nga zyrtarja monitoruese ne proces. Si i tille pretendimi nga shifra 1861 është i pabazuar."

OE ankues si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së të datës 13.10.2023 ka dorëzuar ankesë në OSHP të protokolluar me numër 2023/0823.

Me qëllim të hapjes së kopjes së ofertës, eksperti ka kërkuar përmes email-it me datë 15.11.2023 nga zv.Kryesuesja e Sekretariatit të OSHP-së formimin e një komisioni për hapjen e kopjes së ofertës me prezencën e palëve. Zv.Kryesuesja e Sekretariatit të OSHP-së me datë 16.11.2023 ka nxjerr vendimin numër 823/23 për emërimin e komisionit për hapjen e kopjes së propozimit të dorëzuar nga OE ankues me përbërje: 1.Visar Basha, 2.Kreshnik Spahiu dhe 3.Gjemajli Bellanica.

Me datë 22.11.2023, në prezencë të përfaqësuesve të OE ankues dhe përfaqësuesve nga Ministria e Kulturës, Komisioni ka bërë hapjen e kopjes së propozimit dhe është konstatuar sejanë dorëzuar:*Matrica e programimit* dhe *Raport mbi qasjen dhe metodologjinë projektuese.* Në fund të procesit të hapjes është përpiluar procesverbali dhe është nënshkruar nga Komisionin dhe përfaqësuesit e Ministrisë dhe OE ankues.

Andaj, sipas fakteve dhe provave shkresore në procedurë, eksperti sqaron se në lidhje me qasjen në dokumentet e ofertës te OE ankues, përkatësisht kopjet e ofertës, AK nuk ka vepruar në përputhje me Rregulloren 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 31.3, në të cilin tuhet: "*Tenderi do të dorëzohet të AK në një formë të origjinalit dhe një numër të kopjeve të cilat AK i ka kërkuar në mënyrë të qartë në dosjen e tenderit. Tenderi origjinal si dhe kopjet e kërkuara do të jenë identike. Kopjet hapen në shërbim të komisionit vlerësues."*.

Më tej në lidhje me arsyet për eliminim të cekura në vendimin e AK-së të datës 09.10.2023, ashtu sikurse është sqaruar mësipër, në hapjen e kopjes së ofertës me datë 22.11.2023, në prezencë të përfaqësuesve nga AK dhe OE, komisioni i hapjes në OSHP ka konstatuar se janë dorëzuar dokumentet "*Matrica e programimit"* dhe "*Raport mbi qasjen dhe metodologjinë projektuese"*, rrjedhimisht eksperti vlerëson se pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **SHM Architecture SH.P.K.**

Kreshnik Spahiu